

Vendim nr. 164, datë 22.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Illir Toska, Anëtar

Genti Ibrahimimi, Anëtar

në datën 22.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (V) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **VLADIMIR MYDINI**, përfaqësuar nga avokati Armando Syri, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 2323, datë 06.06.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-4690, datë 23.12.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 15, 18, 26, 42, 43, 44, 49, 59, pikat 1, shkronja “a” dhe 2, 131, shkronja “f”, 133, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 4, 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë në marrëdhënie pune në ndërmarrjen e ndërtimit të rrugëve rurale, Berat. Në datën 18.09.2015 këshilli i qarkut Berat, në cilësinë e punëdhënësit, e ka komanduar kërkuesin në detyrën e drejtorit të asaj ndërmarrjeje, ndërsa në datën 25.11.2015 e ka njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në datën 31.12.2015. Njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës është bazuar në vendimin nr. 915, datë 11.11.2015 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi nga këshillat e qarqeve të bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve” (VKM-ja nr. 915/2015).

2. Në vijim, me shkresën nr. 87 prot., datë 27.11.2015, kërkuesi, në cilësinë e drejtorit të ndërmarrjes së rrugëve rurale, Berat, ka njoftuar veten për zgjidhjen e kontratës së punës në zbatim të VKM-së nr. 915/2015, duke shënuar se efektet financiare do të ndërpriteshin në datën 30.04.2016. Megjithatë, marrëdhëniet e punës atij iu ndërpre në datën 31.12.2015, sipas njoftimit nga punëdhënësi, këshilli i qarkut Berat.

3. Duke mos qenë dakord me zgjidhjen e kontratës së punës, kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë, me objekt: i) shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga zgjidhja e menjëhershme dhe e pajustificuar e kontratës së punës; ii) shpërblimin për moszbatimin e afatit të njoftimit; iii) shpërblimin për moszbatimin e procedurës sipas nenit 144 të Kodit të Punës; iv) shpërblimin për vjetërsi në punë; v) shpërblimin për pushimet vjetore; vi) pagimin e pagës së papaguar për muajin dhjetor 2015. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 923, datë 03.06.2016, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë, duke njohur vetëm të drejtën e dëmshpërblimit prej 2 muajsh pagë për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës, ndërsa ka rrëzuar kërkimet e tjera.

4. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 2323, datë 06.06.2018, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-4690, datë 23.12.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit.

5. Në datën 03.03.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankimin kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 17.03.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara i janë cenuar:

- 6.1. *Parimet e sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit*, të garantuara nga nenet 4 dhe 18 të Kushtetutës, pasi ai kishte pritshmëri të ligjshme se marrëdhënia e punës do t'i ndërpritej në datën 30.04.2016, sipas njoftimit që ai i kishte dërguar vetes dhe jo në datën 31.12.2015, kur e ka njoftuar këshilli i qarkut Berat. Gjykatat e zakonshme duhet ta zgjidhnin çështjen sipas vendimit unifikues nr. 19, datë 15.11.2007 të Kolegjeve të Bashkuara dhe vendimit njëses nr. 724, datë 12.12.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke arritur në përfundimin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës së kërkuesit kishte qenë e menjëhershme dhe duhej t'i jepnin atij shpërblimet përkatëse.
- 6.2. *E drejta e rehabilitimit dhe e shpërblimit të drejtë*, e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, pasi gjykatat e zakonshme, duke mos zbatuar drejt ligjin dhe Kushtetutën, i kanë mohuar kërkuesit të drejtën për të marrë dëmshpërblim për shkak të largimit nga puna.
- 6.3. *Forca detyruese e vendimeve të Gjykatës*, e garantuar nga neni 132 i Kushtetutës, pasi gjykatat e zakonshme nuk kanë zbatuar vendimin nr. 47, datë 11.06.2024 të Gjykatës në lidhje me parimet e sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës,

pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Natyra kumulative e kritereve paraprake të legjitimitit do të thotë se mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të legjitimitit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuenin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë, si pasojë, moskalimin e saj në seancë plenare.

9. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson të ndalet në analizën e legjitimitit *ratione materiae*. Në këtë drejtim, kërkuesi ka pretenduar se i janë cenuar parimet e sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit, e drejta e rehabilitimit dhe e shpërblimit të drejtë, pasi gjykatat e zakonshme kanë zbatuar keq ligjin, si dhe nuk kanë respektuar fuqinë detyruese të vendimeve të Gjykatës. Konkretisht, sipas tij, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të kishin zbatuar nenet 138, pika 3, dhe 143 të Kodit të Punës, në përputhje me vendimet unifikuese/njësuese të Gjykatës së Lartë, si dhe jurisprudencën kushtetuese, ndaj duhet të kishin arritur në përfundimin se zgjidhja e kontratës në rastin e tij kishte qenë e menjëhershme dhe duhej t'i jepnin atij shpërblimet përkatëse.

10. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se përcaktimi i fakteve dhe zbatimi i ligjit në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që Gjykata ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 85, datë 23.12.2025; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 11, datë 11.02.2026; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Kolegji vëren se gjykatat e faktit, bazuar në provat e shqyrtuara, kanë arritur në përfundimin se kontrata e punës së kërkuesit ishte zgjidhur për shkak të ristrukturimit të ndërmarrjes dhe se, në përputhje me kohëzgjatjen e tij në detyrën e drejtorit të komanduar, shkak i ishte njoftuar sipas afatit të përcaktuar në nenin 143 të Kodit të Punës, ndaj nuk mund të pretendohet se ishte zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës. Ato kanë vënë në dukje se kërkuesi jo vetëm kishte marrë njoftim për shkakun që përcaktohej në VKM-në nr. 915/2015, por dhe e kishte zbatuar atë VKM në pozicionin e detyrës së drejtorit të komanduar, duke caktuar përfitimet për vete dhe për punonjësit e tjerë të ndërmarrjes. Gjithashtu, gjykatat e faktit kanë vënë në dukje se kërkuesi kishte përfituar shpërblimin për vjetërsi dhe pagesën e pushimeve vjetore. Së fundmi, gjykatat kanë vlerësuar se procedura për zgjidhjen e kontratës së punës nuk ishte zbatuar sipas nenit 144 të Kodit të Punës, pasi punëdhënësi nuk kishte zhvilluar takimin paraprak për zgjidhjen e kontratës së punës, ndaj kërkuesit i takonte shpërblim prej dy muajsh pagë. Në vijim, Gjykata e Lartë, me arsyetim të kufizuar, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke parashtruar në pjesën hyrëse të vendimit të saj shkaqet e rekursit dhe duke vlerësuar në pjesën arsyetuese se në rekurs nuk paraqitej ndonjë argument i qenësishëm që të mbështeste shkaqet e rekursit sipas ligjit.

12. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se përcaktimi i faktit se zgjidhja e marrëdhënies së punës nuk ka qenë e menjëhershme dhe zbatimi i dispozitave relevante të Kodit të Punës nga gjykatat e zakonshme nuk përmban gabime të dukshme, në kuptimin që ta bëjë rezultatin e gjykimit të padrejtë nga pikëpamja kushtetuese. Në këto kushte, pretendimi i kërkuesit se gjykatat duhet të kishin zbatuar vendimet unifikuese dhe jurisprudencën kushtetuese, që trajton rastin e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës, nuk qëndron. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë haptazi të pabazuara.

13. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.